



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **107**

Prishtinë, më 2.4.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Nijazi Idrizi, Boban Todorović, Salih Morina.

Munguan : Daut Haradinaj dhe Afërdita Berisha-Shaqiri.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 18.3.2013,
3. Shqyrtimi i gjendjes aktuale në pyjet e Kosovës,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime, por me një shtesë tek pika të ndryshme ku do të shqyrtohet tema e referuar nga zyrtarët e ZRRUM.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.3.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 18.3.2013.

3. Njoftimi nga Kryeshefi Ahmet Zejnullahu me bashkëpunëtorë rreth gjendjes aktuale në pyjet e Kosovës

Kryetari Nait Hasani falënderoj zyrtarët e APK për përgjigje në ftesë dhe arsyetoi këtë kërkesë për njoftimin e komisionit ngase në bazë të gjendjes aktuale dhe monitorimeve gjatë vitit 2012, gjendja është shumë e rëndë sa i përket pyjeve për shkak të parregullsive si dhe faktit që pas kthimit nga ana e Kuvendit të Projektligjit për pyje mbrapa në Qeveri, nuk shihen shenja të përmirësimit, përkundrazi.

Ahmet Zejnullahu-kryeshefi i APK me dy bashkëpunëtorë (**Besim Zogaj** dhe **Kadri Kadrijaj** eprorë të departamenteve për ekoturizëm dhe inspektorat në APK) gjithashtu falënderoi për bashkëpunim dhe japi sqarimet e duhura fillimisht për të pasur kohë edhe për komente dhe pyetje nga komisioni, ai posaçërisht potencoi faktin se APK nuk është përgjegjëse e vetme për gjendjen në pyjet e Kosovës, ndaj për të pasur pasqyrë të plotë ai sugjeroi që komisioni të ftoi edhe akterët tjerë (Komunat, Departamentin përkatës në MB, Agjencinë e emergjencave në MPB etj), sidomos nga koha kur kompetencat janë deleguar Komunave sa i përket mbrojtjes së pyjeve. Në vazhdim ai diskutoi rreth :

- inventarizimeve që janë bërë tek pyjet që nga viti 2003 ku 90% struktura e tyre është fletore ndërsa 10% halore, ndërsa sivjet do të përfundoi inventarizimi i paraparë me çka parashihet shtimi i sipërfaqeve pyjore (por ka edhe rigjenerim natyral) me plane menaxhuese ku do të angazhohet edhe FAO,
- ngritjes së fletëparaqitjeve për kundërvajtje dhe ato penale me shifra të caktuara, konfiskimeve etj,
- shkaktimin e zjarreve dhe shkaqet e shkakimit të tyre (në Koretnik etj) dhe kompetencat aktuale të komunave të cilat kanë vështirësi (sidomos intervenimet kufitare komunale janë çështje diskutabile),
- pyllëzimet e sipërfaqeve të zhveshura dhe zëvendësimet e fidaneve të reja si dhe furnizimi me dhe humusor, prodhimi i fidaneve, riparimet e serrave të vjetra etj,
- dy Ligjeve të miratuara për parqet nacionale me sipërfaqe tejet të mëdha, me të cilat do të shkaktohen vështirësi menaxhuese pyjore,
- të hyrat financiare të cilat çdo vit rriten mirëpo assesit nuk zvogëlojnë problemet aktuale ngase të hyrat nga pyjet janë tepër të ulta.

Kryetari falënderoi dhe hapi diskutimin, ndërkaq **Nijazi Idrizi** pasi që përshkroi gjendjen e rëndë në pyjet e Kosovës konstatoi se reforma e paraparë rreth mbrojtjes së pyjeve nuk ka pasur sukses për shkak të jo kompatibilitetit të ligjeve, ndaj propozoi që kryetari i komisionit të angazhohet rreth hapjes së debatit të gjerë në nivelet që menaxhojnë me pyjet, ngase në njërin anë një familjes Kosovare i nevojiten mesatarisht 7 metra kub për ngrohje gjatë një viti, ndaj kjo duhet të balancohet me shënimet e cekura këtu nga zyrtarët e APK, për shkak të presionit nga opinioni të mundësohet shitja në treg e drunjve për të mos atakuar pyjet me prerje ilegale, ai përgëzoi që tani po punohet me planifikim menaxhues dhe parashtrroi pyetjet : në 40%-shin e paraparë a hyjnë zonat e mbrojtura dhe sa paguajnë taksapaguesit për menaxhimin e pyjeve (sugjeroi harmonizimin e strukturave me gjendjen ekzistuese). **Sevdije Lama** parashtrroi pyetje : cilat janë vështirësitë menaxhuese në APK për shkak të parqeve nacionale të shpallura, sa janë të informuar për projektin e Brezovicës dhe a do të mbeten aty zonat strikte si dhe projekti për “Shkugëzën” në Gjakovë ku është sa i përket zbatimit lidhur me pastrimin e pyjeve. **Salih Morina** shprehu pajtimin e cekur më lart që në këtë debat do të ishte mirë të marin pjesë të gjithë akterët rreth pyjeve dhe mbrojtjes së tyre, sidomos gjykatat ku kemi më tepër ndëshkime stimuluese sesa të merituara , ndaj pyeti : pse komunat nuk mund të realizojnë kompetencat e tyre, sa është numri i prerjeve ilegale, a do të ndodhë pajisja me armë për rojet e pyjeve (lidhur me armë kryeshefi tha se po zbatohet ky urdhër për armatimin e rojeve) , a ka plane për mbrojtjen nga djegëjet e pyjeve që shkaktohen zakonisht verës apo është formuar ndonjë komision i veçantë që do të përcjellë gjendjen. **Liburn Aliu** pyeti për prerjet në Sharr në cilat

zona janë planifikuar të bëhen dhe cilat janë planet për prerje ilegale dhe a ka efekte pyllëzimi. **Kryetari Nait Hasani** parashtrroi disa pyetje të cilat janë dërguar me shkrim në komision : pse është përjashtuar nga puna punëtorja Miradije Gashi nga Peja për shkak se është interesuar për keqpërdorime rreth pyjeve, kundërshtimi i UA në ministrinë e bujqësisë me Ligjin aktual për pyje rreth ndërrimit të destinimit, pse nuk ka fletëparaqitje (penale apo kundërvajtje) për zyrtarët e APK, cilat janë masat për prerjet ilegale, sëmundjet tek halorët, zjarret e vitit 2012, hapja e korridoreve që pengojnë apo zvogëlojnë dëmet e zjarrit, a kemi të bëjmë me konflikt interesi pasi Inspektorati i pyjeve udhëhiqet nga APK. **Nijazi Idrizi** u ndërlidh me konstatimin se prerjet ilegale nuk janë problem për shkak se problem i vërtet duhet të janë prerjet legale-si të bëhen ato, pyjet mbrohen me dije jo me armë (mbrojtja me armë është qasje e gabuar), ndaj duhet bashkërisht të gjendet rrugëzgjdhje e duhur. **Ahmet Zejnullahu** përgjigjet i filloi me konstatimin se pyetja e parashtruar nga i ashtuquajti Inspektor, nuk ka të bëjë me personin kompetent, ngase atë nuk e njeh si inspektor, ndërsa për shumicën e pyetjeve ai tha se përgjigja është në pamundësinë e veprimit të APK me vetëm 5-6 inspektor si dhe nga fakti se roli i APK është monitorues, gjithashtu ai premtoi se në disa pyetje do të përgjigjet me shkrim me fakte konkrete rreth riparimeve që janë bërë, fletëparaqitjeve, shpenzimeve etj, për projektin e Brezovicës tha se nuk është konsultuar dhe nuk ka dëgjuar, ndërsa për punëtoreshen e përjashtuar nuk kishte ndonjë koment të veçantë përveç se ajo mund të kthehet në punë , nëse këtë e miraton gjykata kompetente (ai shtoi se ka shumë raste kur të larguarit nga puna kthehen prapë për shkak se kanë njoftësi). Disa komuna , vazhdoi, nuk i kryejnë obligimet e veta për çka nuk është përgjegjëse APK (p.sh. nuk shpenzojnë mjetet financiare të parapara etj), për ngrohje familjare ende nuk ka burime alternative ndërsa APK ka ndërpre çdo aktivitet në parqet nacionale rreth tenderëve për prerje. Duke u bashkëngjitur Drejtori nga APK tha se fotot që u treguan nga ana e kryetarit mund të përdoren varësisht se për çka është fjala, ngase edhe gjërat pozitive mund të tregohen me foto, e vërteta sipas tij është se janë ndërmarr mjaft masa për parandalimin e shkatërrimeve të pyjeve. **Kryetari** prapë përsëriti disa pyetje të cilat mbetën pa përgjigje, p.sh. pse nuk hapen koridoret për parandalim të zjarreve, pse lejohet vazhdimi i prerjeve për çka kryeshefi tha se ato janë në kompetencën e komunave, ndërsa APK shumicën e veprimeve i ndërmerr në baza vullnetare. Në pyetjen pse një kompani 10 vite me radhë merr tenderat (kompania “Minatori”), përgjegjja ishte se APK nuk bënë përzgjedhjen e kompanisë por Komunitat. **Liburn Aliu** konstatoi se Komunitat kanë kompetenca por pyeti pse nuk reagohej pasi që dihet sa kanë shumë pak potencial ato, ndaj pyeti për rastin e Koritnikut : çka mundet komuna e Dragashit me ndërmarr për gjithë atë potencial pyjor, por konstatohet përgjegjësia shkel e shko duke u sill kështu sikurse në rreth, ngase sistemit i konvenon kështu. Ai shtoi se Kuvendi duke parë këtë gjendje, ka bërë atë që ka pasur mundësi, ka shpallur parqet për ti mbrojtur pyjet. **Kryeshefi** përsëriti përgjegjen e lartcekur se vet Komunitat janë ato që kanë kërkuar kompetenca, mirëpo faji është tek mosuniteti dhe mosmarrja nga askush e përgjegjësisë, njëherit u përgjigj në pyetjen pse me armë, ngase funksionimi si është këtu askund nuk është, ndaj si të mbrohen ndryshe pos me armë, problem tjetër ceku se duhet të hiqet Neni 7 nga projektligji që u kthi nga Kuvendi për shkak se APK nuk është ajo që ishte, jemi larg, përfundoi. **Salih Morina** për shkak të defekteve të shumta propozoi të ndërprehen këto diskutime në këtë mbledhje ngase çështja kryesore që duhet të bëhet, është ajo se duhet të bashkohen të gjithë ata që kanë kompetenca për pyje dhe të arrihet bashkërisht në konkludime dhe aktivitete të përbashkëta. **Kryetari Nasit Hasani** përkrahu sugjerimet për një debat të gjërë, por apeloi të mos të sulmohen Ligjet për parqe duke hutuar qytetarët se ju rrezikohen pronat e tyre, ndaj duke përfunduar këtë takim me zyrtarët e APK ai falënderoi dhe njoftoi se gjatë monitorimit të Ligjit për pyje Komisioni do të shqyrtoj mundësitë më të mira për mbrojtjen e pyjeve.

4. Të ndryshme

Kryetari ftoi Drejtorin e ZRRUM z. **Raif Pretenin** të cilin e njoftoi se Kuvendi ka pranuar sot raportin vjetor me shkrim nga ky organ i pavarur i cili raport do të shqyrtohet nga Komisioni pas dy javësh, ndërsa lidhur me iniciativën për nxjerrjen e Ligjit për ZRRUM njoftoi për obligimet

sipas rregullores ku do të paraqitet nevoja për krijimin e grupit punues dhe për ekspert, për çka Kuvendi përkatësisht komisioni nuk ka mundësi të mëdha financiare. Drejtori z. Preteni njoftoi komisionin se deri 15 qershor duhet të njoftoi organet kompetente për fatin e Ligjit në fjalë, ndaj shprehu gatishmërinë për ndihmë dhe bashkëpunim. **Liburn Aliu** ndërhyri duke bërë vërejtje se ZRRUM nuk bënë të paguaj për ekspert, ngase do të kishim konflikt interesi, ndaj sugjeroi që bashkërisht me stafin të shqyrtohen mundësit për një hartim sa më të mirë të Ligjit duke shfrytëzuar potencialet e Kuvendit për analiza dhe ekspertiza, fillimisht duke krijuar grupin punues, pastaj puna vazhdon deri tek hartimi si parashihet me rregullore, ai gjithashtu bëri ca vërejtje rreth tarifave ujore, por Komisioni vendosi që një debat i tillë të zhvillohet pas dy javësh kur do të shqyrtohet raporti vjetor nga ky organ i pavarur.

Me rastin e ftesës për raportim të Ministres Mimoza Kusari-Lila, **Salih Morina** kërkoi një njoftim paraprak nga stafi rreth temës që është ftuar Ministrija, për projektin e Brezovicës.

Mbledhja përfundoi në orën 13,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani